

**L I G J**  
**Nr. 8537, datë 18.10.1999**

**PËR BARRËT SIGURUESE<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9524, datë 25.4.2006, nr. 10 022, datë 24.11.2008, nr.10 185, datë 5.11.2009, nr. 132/2013, datë 29.4.2013, nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**  
**K R E U I**  
**PËRKUFIZIMET DHE FUSHA E ZBATIMIT TË LIGJIT**

Neni 1

**Përkufizime**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

Përkufizimet e përdorura në këtë ligj për qëllime të këtij ligji, kanë kuptimin që u është dhënë në këtë nen. Numri njëjës i emrave përfshin edhe shumësin dhe anasjelltas, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe.

Barrë siguroese - është një e drejtë reale mbi pasuri të paprekshme ose pasuri të luajtshme të prekshme, si të tashme, ashtu dhe të ardhme, që siguron një ose më shumë detyrime që kanë lindur përpara ose pas lidhjes së marrëveshjes siguroese.

Barrë siguroese për çmimin e blerjes - është barra siguroese mbi mallrat, që merret apo mbahet nga shitësi i tyre për të siguruar të gjithë apo një pjesë të çmimit të tyre të blerjes. Barrë siguroese për çmimin e blerjes është edhe ajo që merret nga një person që nuk është shitësi, i cili duke dhënë paradhënie apo duke marrë përsipër një detyrim jep vlerë me qëllim që t'i mundësojë barrëdhënësit të fitojë pronësinë e kolateralit. Barra siguroese për çmimin e blerjes përfshin të drejtën e pronësisë së shitësit, qiradhënësit apo porositësit në transaksionet e përshkruara në nenin 2 të këtij ligji. Barra siguroese për çmimin e blerjes siguron edhe interesin dhe komisionet e kredisë që duhet t'i paguhen barrëmarrësit. Nuk krijon barrë siguroese për çmimin e blerjes transaksioni sipas të cilit një palë i shet pasurinë një pale tjetër, e cila nga ana e saj ia shet apo ia jep me qira pasurinë shitësit.

Barrëdhënës - është personi që ka detyrimin dhe që ka në pronësi kolateralin. Në rast se

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 8537, datë 18.10.1999 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 29/1999.

Ligji nr. 9524, datë 25.4.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.48, datë 9 prill 2006.

Ligji nr. 10 022, datë 24.11.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 186, datë 26 dhjetor 2008.

Ligjin nr. 10 185, datë 5.11.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 161, datë 26 nëntor 2009.

Ligji nr. 132/2013, datë 29.4.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79, datë 14 maj 2013.

Ligji nr. nr. 101/2016, datë 20.10.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 207, datë 4 nëntor 2016.

këta janë persona të ndryshëm, barrëdhënës është pronari i kolateralit kur dispozitat e këtij ligji trajtojnë kolateralin dhe debitori kur dispozitat e këtij ligji trajtojnë detyrimin. Barrëdhënës është blerësi, qiramarrësi apo komisioneri në transaksionet e përshkruara në nenin 2.

Barrëmarrës - është personi në favor të të cilit krijohet barra siguroese sipas nenit 2, përfshirë shitësin, qiradhënësin ose porositësin.

Ceduesi - është personi, ndaj të cilit debitori i llogarisë ka një borxh dhe i cili e transferon këtë borxh te një person tjetër. Për efekt të këtij ligji, ceduesi trajtohet si barrëdhënës kur cedimi është kryer nëpërmjet barrës siguroese ose shitjes së llogarive.

Cesionari - është personi, të cilit ceduesi i transferon llogarinë që debitori i llogarisë i detyrohet ose do t'i detyrohet në të ardhmen. Për efekt të këtij ligji, cesionari trajtohet si barrëmarrës kur cedimi është kryer nëpërmjet barrës siguroese apo shitjes së llogarive.

Debitor i llogarisë - është personi, i cili ka ose do të ketë në të ardhmen një detyrim në para ndaj një personi tjetër.

Dijeni - Në këtë ligj, një person konsiderohet se ka dijeni për një çështje kur ai është vënë në dijeni për çështjen në rrethana të cilat do të ishin të mjaftueshme për një person të arsyeshëm për të marrë dijeni. Një person juridik privat ose publik, institucion ose zyrë shtetërore konsiderohet se ka dijeni për një çështje, kur funksionari apo punonjësi përgjegjës për çështjen ka marrë dijeni në rrethana të cilat do të ishin të mjaftueshme për një person të arsyeshëm për të marrë dijeni ose kur një shkresë për çështjen është dorëzuar në selinë ose në vendin ku vepron personi juridik, në institucionin apo në zyrën përkatëse shtetërore.

Dokument pronësie - është shkresa që lëshohet nga një person ose që i drejtohet një personi që ka në posedim mallra. Shkresa përshkruan mallrat dhe përcakton se mallrat do t'i dërgohen personit që caktohet në shkresë, prurësit të shkresës ose me porosi të një personi të caktuar.

Instrument - është një e drejtë që i jep zotëruesit të saj përfitimin e një vlere në para mbi bazën e një marrëveshjeje të nënshkruar më parë.

Kolateral - është pasuria e luajtshme që është objekt i barrës siguroese. Kolaterali mund të ekzistojë ose mund të krijohet në të ardhmen dhe nuk kufizohet vetëm në pasuritë e luajtshme mbi të cilat barrëdhënësi ka pronësinë apo një të drejtë të tashme. Kolaterali mund të ndodhet kudo, brenda ose jashtë Shqipërisë. Kolaterali përfshin të ardhurat kolateral.

Kreditor ekzekutues - është kreditori i pasiguar i cili ka marrë masat e nevojshme për marrjen e kolateralit nga zyra e përmbarimit në zbatim të një urdhëri ekzekutimi sipas Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Kryeregjistruesi - është Kryeregjistruesi i Regjistrimit të Barrëve Siguroese që emërohet sipas nenit 25 të këtij ligji.

Tituj - janë instrumente, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin e posaçëm për titujt.

Llogari - është detyrimi në para që nuk pasqyrohet në një instrument ose titull dhe që ekziston pavarësisht nëse debitori ka përmbushur ose jo detyrimin.

Mallra - janë sende të luajtshme të prekshme. Ato përfshijnë sende të luajtshme që bashkohen me sende të tjera të luajtshme apo të paluajtshme. Në këtë ligj mallrat ndahen në tre kategori të ndryshme:

“mallra konsumi” do të thotë mallra që përdoren apo blihen për përdorim kryesisht personal, familjar ose shtëpiak;

“inventare” do të thotë mallra të cilat mbahen nga një person për t'u shitur apo për t'u dhënë me qira, ose që janë dhënë me qira nga ai person si qiradhënës. Ky përkufizim përfshin edhe mallrat që furnizohen apo mallrat që do të furnizohen sipas kontratave të ndryshme për

kryerje shërbimesh;

“pajisje” do të thotë mallra të cilat përdoren vetëm për veprimtari tregtare dhe që nuk janë as mallra konsumi dhe as inventare.

Marrëveshje siguroese - është marrëveshja që lidhet midis palëve për një ose disa nga transaksionet e përshkruara në nenin 2.

Njoftimi i regjistrimit - është një formular i përcaktuar nga Rregullorja, i cili përdoret për të transmetuar informacionin që do të përfshihet në regjistrim, duke përfshirë ndryshimin, fshirjen ose nënrenditjen e regjistrimit, dhe kur është e përshtatshme, përfshin një formular elektronik.

Regjistër - është Regjistri i Barrëve Siguroese që krijohet sipas nenit 25 të këtij ligji.

Regjistrim - është regjistrimi i të dhënave apo të dhënat e regjistruara me anë të përdorimit të një njoftimi regjistrimi.

Pasuri e paprekshme - është çdo lloj pasurie që nuk është send, instrument ose titull. Janë pasuri e paprekshme pronësia intelektuale, llogaritë etj.

Të ardhurat kolateral - janë ai lloj i veçantë kolaterali që rrjedh drejtpërdrejt apo tërthorazi nga veprimet me kolateralin. Ai përfshin edhe të ardhurat kolateral të radhës së dytë e më tej, si dhe të ardhurat e shpërblimit nga sigurimi.

## Neni 2

### **Fusha e zbatimit të ligjit**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

Ky ligj zbatohet për transaksione të çdo forme ose emërtimi që krijojnë barrë siguroese mbi sende të luajtshme ose pasuri të paprekshme ose mbi të drejtat e pronarit me anë të transferimit të titullit të pronësisë, posedimit me anë pengu ose me çdo mënyrë tjetër.

Rregullat që zbatohen në marrëveshjet siguroese, zbatohen edhe në transaksionet e mëposhtme të cilat në këtë ligj, konsiderohen marrëveshje siguroese:

a) kontrata e shitjes me rezervë të mallrave deri në çastin e pageses të çmimit të plotë të shitjes dhe përmbushjen e çdo detyrimi tjetër;

b) shitja e një ose disa llogarive;

c) komisioni i mallrave, duke përfshirë kalimin e posedimit të tyre nga pronari tek komisioneri me qëllim që ky i fundit t'i shesë ato; dhe

ç) qiraja e mallrave me afat mbi një vit.

Rregullat që zbatohen për barrëmarrësin ose për të drejtat dhe detyrimet e barrëmarrësit zbatohen njëjloj edhe për:

a) shitësin në një kontratë të shitjes me rezervë të mallrave;

b) shitësin e llogarive;

c) porositësin në një kontratë komisioni;

ç) qiradhënësin në kontratën e qirasë së mallrave me afat mbi një vit.

Rregullat që zbatohen për barrëdhënësin ose për të drejtat dhe detyrimet e barrëdhënësit zbatohen njëjloj edhe për:

a) blerësin në një kontratë të shitjes me rezervë të mallrave;

b) blerësin e llogarive;

c) komisionerin në një kontratë komisioni;

ç) qiramarrësin në kontratën e qirasë së mallrave me afat mbi një vit.

Neni 3  
**Barra siguroese dhe detyrimi i siguruar**

Nuk mund të krijohet barrë siguroese mbi pasurinë e debitorit apo të bashkëshortes së tij, që përjashtohet nga sekuestroja sipas Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Një detyrim mund të jetë me kusht ose mund të mos jetë detyrim në para, por megjithatë ai duhet të jetë gjithmonë i vlerësueshëm në para.

Detyrimi mund të jetë ai i pronarit të pasurisë mbi të cilën vihet barra siguroese ose detyrimi i një personi tjetër.

Neni 4  
**Përjashtimet**

*(Shtuar shkronja “ë”, me ligjin nr. 132/2013, datë 29.4.2013, ndryshuar me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

Ky ligj nuk zbatohet për:

- a) cedimin e pretendimeve të punëmarrësit për t’u shpërblyer;
- b) shitjen e llogarive si pjesë e shitjes së veprimtarisë tregtare, prej së cilës ato kanë lindur;
- c) cedimin e një të drejte kontrate për shpërbllim të cesionarit, kur cesionari ka detyrim të përmbushë detyrimet e ceduesit në kontratë;
- ç) cedimin e së drejtës për pagesë në rastin e hipotekës mbi ose të qirasë;
- d) cedimin e llogarive, që bëhet vetëm për të lehtësuar mbledhjen e llogarive për ceduesin;
- dh) cedimin e të drejtave që burojnë nga vendime gjyqësore, por jo nga vendime gjyqësore që njohin të drejtën e pagesës së një shume që është kolateral;
- e) transaksionet e rregulluara me ligj tjetër të shtetit shqiptar apo marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe apo shumëpalëshe të njohura dhe të ratifikuara nga shteti shqiptar që parashikojnë krijimin, kompletimin, preferimin apo ekzekutimin e barrës siguroese.
- ë) marrëveshjet e kolateralit financiar, të rregulluara me ligj të posaçëm.

**KREU II**  
**EFEKTET E BARRËS SIGUROESE PËR PALËT NË MARRËVESHJE**

Neni 5  
**Krijimi i barrës siguroese dhe kolaterali**  
*(Ndryshuar me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

Barra siguroese lidhet me kolateralin dhe ka efekt ligjor kundrejt barrëdhënësit dhe palëve të treta, vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) barrëdhënësi dhe barrëmarrësi nënshkruajnë një marrëveshje siguroese me shkrim, e cila përmban një përshkrim të kolateralit;
- b) barrëdhënësi është pronari i kolateralit ose personi, i cili ka tagrat për të lidhur marrëveshjen siguroese në emër të pronarit të kolateralit; ose barrëdhënësi është blerës, sipas një kontrate shitjeje me rezervë të mallrave, blerës i llogarisë, komisioner dhe qiramarrës në kontratën e qirasë së mallrave me afat mbi një vit;

c) barrëmarrësi ka lidhur kontratë me barrëdhënësin për t'i dhënë kredi ose hua barrëdhënësit ose një personi tjetër, ose për të përmbushur një detyrim për llogari të barrëdhënësit, ose barrëmarrësi i ka dhënë kredi ose hua barrëdhënësit ose një pale të tretë përpara lidhjes së marrëveshjes siguroese.

Kur marrëveshja siguroese parashikon vendosjen e një barre siguroese mbi kolateralin që fitohet nga barrëdhënësi pas lidhjes së marrëveshjes, barra siguroese lind:

a) në çastin e fitimit të pronësisë nga barrëdhënësi, pa qenë nevoja që barrëmarrësi ose barrëdhënësi të kryejnë ndonjë veprim;

b) në çastin e kalimit të posedimit të mallrave të barrëdhënësi, në rast se barrëdhënësi është blerës në një kontratë shitjeje me rezervë të mallrave;

c) në çastin e kalimit të posedimit të mallrave të barrëdhënësi, në rast se barrëdhënësi është komisioner ose qiramarrës në kontratën e qirasë së mallrave me afat mbi një vit;

ç) në çastin e krijimit të llogarisë, kur barrëdhënësi është ceduesi i llogarisë.

Marrëveshja siguroese mund t'u referohet një ose disa barrëve siguroese, të cilat nuk është e detyrueshme të pasqyrohen në një akt të vetëm.

Përshkrimi i kolateralit është i mjaftueshëm kur mundëson cilësimin e kolateralit. Përshkrimi mund të jetë i përgjithshëm ose i detajuar dhe mund t'u referohet edhe llojeve të pasurive që mund të fitohen nga barrëdhënësi në të ardhmen. Përshkrimi mund të bëhet duke vendosur një kusht në marrëveshjen siguroese sipas të cilit barra siguroese vendoset:

a) mbi të gjithë pasurinë që barrëdhënësi ka në çastin e lidhjes së marrëveshjes siguroese si dhe mbi të gjithë pasurinë e fituar pas lidhjes së marrëveshjes siguroese; ose

b) mbi të gjithë pasurinë ekzistuese të barrëdhënësit dhe mbi atë të fituar pas lidhjes së marrëveshjes barrësuese, duke përjashtuar zëra të veçantë apo lloje të pasurisë; ose

c) mbi të gjithë pasurinë ekzistuese të barrëdhënësit dhe mbi atë të fituar pas lidhjes së marrëveshjes barrësuese, e cila është e një lloji të veçantë.

## Neni 6

### **Të drejtat dhe detyrimet e barrëmarrësit që posedon kolateralin**

Barrëmarrësi duhet të tregojë kujdesin e duhur për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e kolateralit që ka në posedim. Barrëmarrësi duhet ta mbajë kolateralin të përcaktueshëm, me përjashtim të rastit kur kolaterali është i një lloji që mund të përzihet me pasuri tjetër.

Çdo shpenzim i nevojshëm që barrëmarrësi bën për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e kolateralit si dhe detyrimet ligjore në lidhje me të janë në ngarkim të barrëdhënësit dhe sigurohen nga kolaterali.

Kur nuk ka marrëveshje të kundërt të palëve, barrëmarrësi mund të mbajë si kolateral shtesë çdo rritje vlere apo fitim që jep kolaterali, me kusht që këto të mos jenë para. Në rast se rritja e vlerës ose fitimi janë para, atëherë barrëmarrësi ose duhet t'ia japë ato barrëdhënësit ose t'i përdorë duke zbritur detyrimin e siguar me barrë siguroese nga barrëdhënësi.

## Neni 7

### **E drejta për të kërkuar të dhëna**

Barrëdhënësi or barrëmarrësi që ka barrë siguroese në pasurinë e këtij barrëdhënësi ose kreditori ekzektues ka të drejtë t'i kërkojë çdo barrëmarrësi tjetër:

a) të miratojë ose të ndreqë listën e kolateralit që siguron detyrimin;

b) të miratojë ose ndreqë një listë e cila, sipas barrëmarrësit, tregon shumën totale të papaguar të detyrimit të siguruar me anë të kolateralit në një datë të caktuar; dhe

c) t'i dorëzojë atij një kopje të marrëveshjes siguroese.

Barrëmarrësi tjetër duhet të kthejë përgjigje për kërkesat e përshkruara në këtë nen brenda dy javësh nga data e marrjes së kërkesës. Barrëdhënësi ka të drejtë të marrë, pa kundërshpërblim, një përgjigje brenda një afati gjashtë mujor. Për çdo përgjigje tjetër, barrëmarrësi mund të kërkojë pagimin e një shume e cila përcaktohet në Rregulloren e barrëve siguroese.

### KREU III

#### EFEKTET E BARRËS SIGUROESE KUNDREJT PALËVE TË TRETA

##### Neni 8

##### **Kompletimi i barrës siguroese**

*(Ndryshuar shkronjat "b" dhe "c" të paragrafit të dytë, me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

Barrë siguroese e kompletuar është barra që përmbush të gjitha kushtet që parashikohen në këtë nen, të cilat mundësojnë që ajo të preferohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Barra siguroese kompletohet kur ajo lidhet me kolateralin në mënyrën e parashikuar nga neni 5 dhe kur përmbushet një nga kushtet e mëposhtme përpara ose pas lidhjes së saj me kolateralin:

a) barra siguroese është regjistruar në një nga mënyrat e parashikuara nga ky ligj; ose

b) barrëmarrësi ose agjenti i tij, që nuk është barrëdhënësi, i posedon fizikisht mallrat, instrumentet, titujt ose paratë siç është pranuar në marrëveshjen siguroese;

c) kur ka një barrë siguroese mbi mallrat që janë në posedim të depozitarit, ky lëshon një dokument pronësie në emër të barrëmarrësit ose pranon të mbajë mallrat për llogari të barrëmarrësit; ose

ç) dispozitat e këtij ligji parashikojnë se barra siguroese është kompletuar.

Kur barra siguroese është kompletuar fillimisht në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe më pas, është kompletuar përsëri në një mënyrë tjetër të parashikuar nga ky ligj, pa patur asnjë periudhë të ndërmjetme gjatë së cilës ajo ka qënë e pakompletuar, sipas këtij ligji ajo konsiderohet në vazhdimësi e kompletuar.

##### Neni 9

##### **Kompletimi i përkohshëm i barrës siguroese mbi kolateralin që i kthehet barrëdhënësit**

*(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

Barra siguroese mbi një instrument, që ka qënë e kompletuar nëpërmjet posedimit nga barrëmarrësi ose agjent i tij, mbetet e kompletuar pa qënë nevoja të regjistrohet për 20 ditë, pasi kolaterali të vihet nën kontrollin e barrëdhënësit për qëllim shitjeje, këmbimi, mbledhjeje, përtëritjeje, regjistrimi ose transferimi.

Barra siguroese mbi mallrat, që ka qënë e kompletuar nëpërmjet:

a) posedimit nga barrëmarrësi; ose

b) lëshimit të një dokumenti pronësie në emër të barrëmarrësit; ose

c) lëshimit të një dokumenti nga një person i cili ka pranuar t'i mbajë mallrat në emër të barrëmarrësit, mbetet e kompletuar, pa qënë nevoja të regjistrohet për 20 ditë pasi mallrat të vihen nën kontrollin e barrëdhënësit për qëllim shitjeje, këmbimi ose për ta përgatitur atë për

shitje ose këmbim.

Pas mbarimit të afatit prej 20 ditësh barra siguroese e humbet kompletimin, përveç rasteve kur barrëmarrësi e kompletton atë përsëri në njëren prej mënyrave të parashikuara nga ky ligj.

Blerësi apo qiramarrësi që e blen apo e merr me qira kolateralin gjatë afatit prej 20 ditësh të përcaktuar në këtë nen, e merr atë të parënduar nga barra siguroese, nëse nuk ka patur dijeni për këtë barrë në momentin e blerjes apo marrjes me qira.

#### Neni 10

### **Barra siguroese mbi garancitë dhe të ardhurat kolateral** (Ndryshuar paragrafi i parë, me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)

Kur mbi një llogari vihet barrë siguroese, barrëmarrësi ka kundrejt dorëzanësit të llogarisë të njëjtat të drejta që ka barrëdhënësi.

Përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe, barra siguroese mbi kolateralin vazhdon edhe kur ai shitet, jepet me qira, përdoret me licencë, këmbehet apo tjetërsohet në ndonjë mënyrë tjetër, po qe se barrëmarrësi nuk ka autorizuar, shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar, tjetërsimin e kolateralit të parënduar nga barrët siguroese.

Barra siguroese mbi kolateral lidhet edhe mbi të ardhurat kolateral, të cilat janë të përcaktueshme.

Kompletimi dhe preferimi i barrës siguroese mbi të ardhurat kolateral mbeten të njëjta, si dhe kompletimi e preferimi i barrës siguroese mbi kolateralin fillestar në qoftë se:

a) regjistrimi me anë të të cilit është kompletuar barra siguroese mbi kolateralin fillestar, përfshinte përshkrimin e të ardhurave kolateral, kur ato janë të të njëjtit lloj si kolaterali fillestar; ose

b) ato janë para, çek apo depozitë në bankë ose në institucione financiare që pranojnë depozita.

Kur nuk aplikohet paragrafi i mësipërm, barra siguroese mbi të ardhurat kolateral, e cila është kompletuar me posedim ose me regjistrim jo më vonë se 20 ditë nga dita e lidhjes së barrës siguroese me të ardhurat kolateral, ka preferim të barabartë me barrën siguroese mbi kolateralin fillestar.

Blerësi apo qiramarrësi që i blen apo i merr me qira të ardhurat kolateral gjatë afatit prej 20 ditësh të përcaktuar në këtë nen, i merr ato të parënduara nga barra siguroese, nëse nuk ka patur dijeni për këtë barrë në momentin e blerjes apo marrjes me qira.

#### Neni 11

### **Preferimi ndërmjet barrëve siguroese** (Ndryshuar paragrafi i tetë, me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)

Kur ky ligj nuk parashikon mënyra të tjera për përcaktimin e preferimit ndërmjet barrëve siguroese, preferimi përcaktohet sipas këtij neni.

Barra siguroese e kompletuar preferohet ndaj barrës siguroese të pakompletuar.

Preferimi ndërmjet dy ose më shumë barrëve siguroese të kompletuara vendoset duke vlerësuar se cila prej këtyre barrëve është kompletuar e para me regjistrim, me posedimin e kolateralit nga barrëmarrësi apo në një mënyrë tjetër që parashikon ky ligj për kompletimin e barrës siguroese.

Kur një regjistrim ka përfunduar, është fshirë gabimisht ose pa autorizimin e barrëmarrësit, dhe barrëmarrësi i dërgon Regjistrin një njoftim reregjistrimi jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit apo fshirjes, përfundimi apo fshirja nuk influencon në preferimin e barrës siguroese në lidhje me një barrë siguroese të kompletuar konkuroese, e cila përpara përfundimit apo fshirjes kishte preferim të nënrenditur. Kjo nuk zbatohet kur, si rezultat i një detyrimi ligjor, kjo barrë siguroese konkuroese siguron kreditë që janë dhënë, ose që duhet të jepen pas përfundimit ose fshirjes së regjistrimit por përpara reregjistrimit.

Preferimi ndërmjet barrëve siguroese të pakompletuara përcaktohet duke vlerësuar se cila barrë është lidhur e para me kolateralin.

Barra siguroese për çmimin e blerjes mbi inventarin ose mbi të ardhurat kolateral të tij, preferohet mbi një barrë tjetër siguroese mbi kolateralin që është dhënë nga i njëjti barrëdhënësi, kur ajo është e kompletuar dhe kur barrëmarrësi i barrës siguroese për çmimin e blerjes njofton barrëmarrësin e mëparshëm jo më vonë nga çasti kur barrëdhënësi merr inventarin në posedim.

Njoftimi mund të tregojë se personi që e bën atë ka barrë siguroese ose pret të ketë barrë të tillë mbi inventarin dhe duhet të përmbajë përshkrimin e kolateralit sipas llojit apo zërave.

Preferohet mbi çdo barrë tjetër siguroese që është dhënë nga barrëdhënësi mbi të njëjtin kolateral:

a) barra siguroese e dhënë mbi kolateralin, për çmimin e blerjes së tij, ose mbi të ardhurat e tij, në rast se është pasuri e prekshme dhe jo inventar, e cila është kompletuar brenda 20 ditëve nga data e posedimit të kolateralit nga barrëdhënësi, ose një person tjetër i autorizuar prej tij;

b) barra siguroese e dhënë mbi një kolateral të paprekshëm, për çmimin e blerjes së tij, ose mbi të ardhurat e tij, e cila është kompletuar jo më vonë se 20 ditë pas datës së lidhjes së saj me kolateralin e paprekshëm.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për preferimin mbi kolateral është në kompetencë të Gjykatës së Apelit.

## Neni 12

### **Preferimi ndërmjet barrëve siguroese të pakompletuara**

Pretendimi i një kreditori i cili bëhet kreditor ekzekutues përpara kompletimit të barrës siguroese, preferohet mbi këtë barrë nëse barrëmarrësi nuk ka regjistruar një njoftim përpara se kreditori të bëhet kreditor ekzekutues ose kur përpara se kjo barrë të kompletohej, barrëmarrësi kishte dijeni për të drejtën e kreditorit ekzekutues.

E drejta e blerësit të kolateralit, i cili e ka blerë atë pa patur dijeni se ka një barrë siguroese mbi të dhe përpara se ajo të kompletohej, preferohet mbi këtë barrë.

E drejta e qiramarrësit të mallrave, i cili ka fituar posedimin e mallrave pa patur dijeni se ka një barrë siguroese mbi to dhe përpara se barra siguroese të kompletohej, preferohet mbi këtë barrë.

## Neni 13

### **Preferimi i barrëve siguroese dhe i pretendimeve të tjera mbi kreditë e ardhme**

Preferimi i barrës siguroese shtrihet mbi të gjitha paratë e dhëna hua ose kreditë, si të tashme ashtu edhe të ardhme, me kusht që këto të jenë dhënë hua në përputhje me marrëveshjen siguroese apo një marrëveshje që ka lidhje me të.

Barra siguroese e kompletuar nuk preferohet mbi të drejtat e kreditorit ekzekutues për



kreditë e dhëna pasi barrëmarrësi merr dijëni për kreditorin ekzekutues.

Megjithatë, pretendimi i barrëmarrësit preferohet mbi pretendimin e kreditorit ekzekutues, pavarësisht nga fakti nëse barrëmarrësi ka dijëni ose jo për ekzistencën e ekzekutimit, kur:

- a) paratë i detyrohen një personi që nuk është barrëdhënësi; ose
- b) ai është detyrim në bazë të ligjit; ose
- c) barrëmarrësi ka kryer shpenzime të arsyeshme për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe ndreqjen e kolateralit.

Barrëmarrësi nuk detyrohet t'i japë huanë barrëdhënësit, nëse barrëmarrësi ka patur dijëni se kolaterali i është nënshtruar ekzekutimit përpara se barrëmarrësi të jepte huanë.

#### Neni 14

### **Preferimi i pretendimeve të blerësit dhe të qiramarrësit të mallrave**

Pretendimi i një blerësi që fiton pronësinë mbi mallrat gjatë veprimtarisë së zakonshme tregtare të shitësit, preferohet mbi barrën siguruese të kompletuar ose të pakompletuar të vënë nga shitësi mbi mallrat, edhe kur blerësi ka dijëni për këtë barrë.

Pretendimi i një qiramarrësi që merr mallrat me qira nga qiradhënësi gjatë veprimtarisë së zakonshme tregtare të këtij të fundit, preferohet mbi barrën siguruese të kompletuar ose të pakompletuar, të vënë nga qiradhënësi mbi mallrat, edhe kur qiramarrësi ka dijëni për këtë barrë.

Pretendimi i blerësit apo i qiramarrësit të mallrave të konsumit apo të mallrave për përdorim bujqësor, që blen apo merr mallrat me qira pa ditur se mbi to ka barrë siguruese, preferohet mbi barrën siguruese të kompletuar ose të pakompletuar, në qoftë se çmimi i shitjes së mallrave ose vlera e tregut për mallrat e dhëna me qira nuk është mbi 40,000 lek.

#### Neni 15

### **Preferimi i pretendimeve që rrjedhin nga ligji**

Kur gjatë veprimtarisë së tij të zakonshme tregtare, një person furnizon materiale ose shërbime që kanë të bëjnë me kolateralin, pretendimi mbi kolateral që njihet nga ligji për vlerën e materialeve apo shërbimeve, preferohet ndaj barrës siguruese mbi këtë kolateral, pavarësisht nëse kjo është e kompletuar ose jo.

#### Neni 16

### **Preferimi i barrëve siguruese mbi mallrat që i janë bashkuar pasurisë së paluajtshme**

Barra siguruese mund të krijohet edhe mbi prodhimet bujqësore ose mbi mallrat që i janë bashkuar ose që do t'i bashkohen pasurisë së paluajtshme. Ky ligj nuk pengon krijimin e hipotekës mbi sendet që i bashkohen pasurisë së paluajtshme sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë apo ligjeve të tjera.

Barrëmarrësi që ka barrë siguruese mbi prodhimet bujqësore dhe mallrat që i janë bashkuar apo do t'i bashkohen pasurisë së paluajtshme gëzon të drejtat dhe preferimet që parashikon ky ligj, kur ato nuk vijnë në kundërshtim me ligje të tjera, të cilat trajtojnë hipotekën.

Barra siguruese e kompletuar mbi prodhimet bujqësore ose mbi mallrat që i janë bashkuar pasurisë së paluajtshme preferohet mbi të drejtat e pronarit të pasurisë së paluajtshme në çastin që mbillet bima apo që mallrat i bashkohen pasurisë së paluajtshme. Edhe kjo barrë

preferohet mbi pretendimin e kreditorit ekzekutues dhe të personit që fiton pronësinë ose hipotekë mbi pasurinë e paluajtshme pasi ajo të jetë kompletuar.

Në rastet e mospërbushjes së detyrimit sipas kreut V, barrëmarrësi që preferohet sipas këtij neni ka të drejtë t'i heqë ose shkëpusë prodhimet bujqësore apo mallrat që i janë bashkuar pasurisë së paluajtshme. Kur pronari i pasurisë së paluajtshme së cilës i janë bashkuar prodhimet bujqësore dhe mallrat nuk është barrëdhënësi, barrëmarrësi duhet ta kompensojë atë për shpenzimet e kryera për riparimin e çdo dëmtimi fizik të pasurisë së paluajtshme, që ka ardhur si pasojë e heqjes apo shkëputjes së prodhimeve bujqësore apo mallrave. Barrëmarrësi nuk ka detyrim të kompensojë zvogëlimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme, që ka ardhur nga heqja apo shkëputja e prodhimeve bujqësore apo e mallrave.

#### Neni 17

### **Preferimi i barrëve siguroese mbi shtesat**

Shtesa janë mallrat që janë lidhur me mallra të tjera në një mënyrë të tillë që ato nuk e humbasin identitetin e tyre fillestar dhe mund të ndahen pa qenë nevoja të bëhen shpenzime thelbësore ose pa i shkaktuar atyre dëmtime thelbësore. Barra siguroese mbi mallrat vazhdon edhe pasi këto mallra bëhen shtesa.

Barra siguroese e kompletuar, mbi mallrat që bëhen shtesë, mbetet e kompletuar edhe mbi shtesën.

Barra siguroese e kompletuar mbi shtesën, preferohet mbi të drejtat e pronarit të mallrave të cilave u është bashkuar shtesa në kohën kur shtesa lidhet me mallrat, si edhe mbi pretendimet e kreditorit ekzekutues dhe ato të personit që fiton të drejta pronësie ose bëhet barrëmarrës i mallrave ose i shtesës, pasi të jetë kompletuar barra siguroese.

Në rast mospërbushjeje të detyrimit, sipas kreut V, barrëmarrësi që preferohet sipas këtij neni mund ta shkëputë shtesën nga mallrat e tjera. Kur pronari i mallrave me të cilat është bashkuar shtesa, nuk është barrëdhënësi, barrëmarrësi duhet ta kompensojë atë për shpenzimet e kryera për riparimin e çdo dëmtimi fizik që vjen nga heqja e shtesës. Barrëmarrësi nuk ka detyrim të kompensojë zvogëlimin e vlerës së mallrave që ka ardhur si pasojë e heqjes së shtesës.

Personi që ka të drejtën e kompensimit, mund të refuzojë heqjen e shtesës për aq kohë sa barrëmarrësi nuk jep garanci të mjaftueshme se do ta përmbushë detyrimin për kompensim.

#### Neni 18

### **Preferimi i barrëve siguroese mbi mallrat e përziera**

Në kuptimin e këtij neni mallra të përziera janë mallrat që u janë bashkuar fizikisht mallrave të tjera e që humbasin identitetin e tyre si rrjedhojë e krijimit të një njësie apo produkti të vetëm.

Nuk mund të krijohet barrë siguroese mbi mallra të përziera, por në rast se kolaterali shndërrohet në mallra të përziera, çdo barrë e tillë mbi kolateralin fillestar i lidhet produktit apo njësisë së përfutur. Barra siguroese e kompletuar mbi mallrat që bëhen mallra të përziera, mbetet e kompletuar edhe mbi njësinë ose produktin. Në qoftë se vlera e njësisë ose e produktit në kohën e ekzekutimit të barrës siguroese është më e madhe se vlera që kishte kolaterali në kohën e shndërrimit të tij në mallra të përziera, barrëmarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e kësaj barre për vlerën e shtuar.

Nëse me njësinë ose produktin lidhet më shumë se një barrë siguroese, ajo që

kompletohet preferohet mbi barrët siguruese që nuk janë kompletuar në çastin kur kolaterali shndërrohet në mallra të përziera.

Kur ka më shumë se një barrë siguruese të kompletuar në kohën që kolaterali është shndërruar në mallra të përziera, ato preferohen në mënyrë të barabartë në përpjestim me vlerën që kishte kolaterali në çastin e shndërrimit të tij në mallra të përziera.

#### Neni 19

### **Preferimi mbi instrumente që parashikohen nga ligje të tjera**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

Barra siguruese e një personi, i cili fiton instrumente, sipas parashikimeve të legjislacionit bankar, preferohet mbi barrën siguruese të kompletuar të mëparshme mbi këto instrumente.

Pretendimi i një personi që blen titull ose përfiton barrë siguruese mbi të, preferohet mbi një barrë siguruese që është kompletuar me regjistrim, në qoftë se ky person fiton titull dhe posedimin mbi të përkundrejt kompensimit, pa pasur dijeni për barrën siguruese.

Pretendimi i cesionarit, i cili merr një dokument pronësie, preferohet mbi barrën siguruese vendosur mbi mallrat në posedim të lëshuesit të dokumentit të pronësisë, në rast se plotësohen njëkohësisht të gjitha këto kushte:

a) cesionari jep kompensim për dokumentin e pronësisë;  
b) cesionari merr posedimin e dokumentit të pronësisë pa pasur dijeni për barrën siguruese;

c) cedimi bëhet në përputhje me kërkesat që përmban dokumenti i pronësisë, të cilat lejojnë transferimin e dokumentit të mbajtësi ose sipas porosisë së tij.

Pretendimi i poseduesit të parave preferohet mbi një barrë siguruese të vënë mbi paratë, në rast se poseduesi i tyre i ka fituar ato pa pasur dijeni se kanë qenë objekt i kësaj barre. Kur poseduesi i parave i ka këmbyer ato me pasuri me po atë vlerë, ose ka marrë përsipër një detyrim, pretendimi i tij preferohet mbi çdo barrë siguruese mbi paratë, pavarësisht nëse në çastin e fitimit të tyre ai ka pasur dijeni ose jo për këtë barrë mbi paratë.

Pretendimi i kreditorit, të cilit i paguhet detyrimi, preferohet mbi një barrë siguruese dhënë mbi paratë e paguara për këtë detyrim dhe mbi instrumentin me të cilin është kryer kjo pagesë. Kjo zbatohet pavarësisht nëse kreditori ka pasur ose jo dijeni për një barrë të tillë në kohën e kryerjes së pagesës dhe kur pagesa është kryer nga barrëdhënësi me anë instrumenti, transferte elektronike fondesh, debitimi, transferte të autorizuar prej tij, apo me një mënyrë të ngjashme pagese.

#### Neni 20

### **Preferimi në rast nënrenditjeje**

Personi që, sipas këtij ligji, ka barrë siguruese të preferuar mund të pranojë të ndryshojë ose të heqë dorë nga preferimi, duke ua kaluar atë të tretëve. Kjo marrëveshje quhet marrëveshje nënrenditjeje.

Marrëveshja e nënrenditjes është e vlefshme vetëm nëse ajo bëhet me shkrim.

## Neni 21

### **Transferimi i të drejtës së barrëdhënësit**

Pronësia e barrëdhënësit mbi kolateral mund të transferohet, por çdo barrë e mëparshme siguroese mbi kolateralin do të ketë përparësi mbi të drejtën e cesionarit mbi kolateral, me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.

## Neni 22

### **Mosmbajtja përgjegjësi nga barrëmarrësi për veprimet ose gabimet e barrëdhënësit**

Kur barrëdhënësit i janë dhënë tagra vetëm për ta tjetërsuar ose përdorur kolateralin, barrëmarrësi nuk mban përgjegjësi për veprimet ose gabimet e barrëdhënësit.

## Neni 23

### **Marrëveshja për të mos ngritur pretendime kundër cesionarit**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

Marrëveshja ndërmjet debitorit dhe ceduesit të një llogarie, sipas së cilës debitori i llogarisë merr përsipër të mos ngrejë kundër cesionarit pretendimet që mund të ketë ndaj ceduesit dhe të mos përdorë mjete të tjera ligjore kundër tij, ka fuqi detyruese edhe për marrëdhënien mes cesionarit dhe debitorit të llogarisë. Kjo zbatohet vetëm kur cesionari e ka marrë llogarinë me kundërshtëpërblim, në mirëbesim dhe pa pasur dijeni për marrëveshjen.

Një marrëveshje e tillë është e pavlefshme, kur bëhet në kundërshtim me nenin 92 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ose kur debitori i llogarisë është mbingarkuar me borxhe ose detyrime, ose kur fillojnë procedurat e falimentimit.

## Neni 24

### **Cedimi**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

Barrëmarrësi mund ta cedojë të drejtën e tij, në përputhje me nenin 499 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Mosnjoftimi i një debitori llogarie për cedimin e një të drejte pagese sjell vetëm pasojat ligjore që parashikohen shprehimisht në këtë nen. Krijimi, lidhja, kompletimi ose ekzekutimi i një barre siguroese mbi një llogari nuk kërkon njoftim.

Në rast se debitori i llogarisë nuk ka bërë një marrëveshje të vlefshme për të mos ngritur pretendime, ose për të mos përdorur mjete të tjera ligjore kundër cesionarit, të drejtat e cesionarit kundrejt debitorit të llogarisë u nënshtrohen:

a) të gjitha kushteve të marrëveshjes ndërmjet debitorit të llogarisë dhe ceduesit, si edhe çdo pretendimi ose mjete ligjor që vjen nga transaksioni, prej të cilit rrjedh llogaria ose një transaksion tjetër që ka lidhje me të;

b) të gjitha pretendimeve ose mjeteve ligjore të debitorit të llogarisë kundër ceduesit, që kanë lindur para se debitori i llogarisë të ketë marrë njoftim me shkrim për cedimin, njoftim që është nënshkruar nga ceduesi ose cesionari.

Debitori i llogarisë ka të drejtë të ngrejë pretendime kundër cesionarit vetëm për të zvogëluar detyrimin që rezulton në llogari.

Në qoftë se ceduesi dhe debitori i llogarisë ndryshojnë kushtet e një marrëveshjeje të lidhur midis tyre, ndryshimet duhet të respektohen edhe nga cesionari, në qoftë se ato janë bërë në mirëbesim dhe në përputhje me normat e arsyeshme tregtare. Cesionari fiton të drejtat e ceduesit, të cilat rrjedhin nga kontrata e ndryshuar. Ky paragraf nuk zbatohet kur e drejta, sipas një kontrate të ceduar, është fituar si rezultat i përmbushjes së plotë të detyrimit dhe kur debitori i llogarisë ka marrë njoftim për cedimin.

Debitori i llogarisë mund ta përmbushë detyrimin duke paguar ceduesin jo më vonë nga data e marrjes së njoftimit, i cili tregon se shuma e kërkuar, ose që do të kërkohej, është ceduar dhe se pagesa duhet t'i bëhet cesionarit. Pas marrjes së njoftimit, debitori i llogarisë mund të çlirohet nga detyrimi në rast se paguan cesionarin, por jo kur paguan ceduesin. Lajmërimi është i pavlefshëm në rast se nuk përshkruan në mënyrë të arsyeshme llogarinë e ceduar.

Me kërkesë të debitorit të llogarisë, cesionari, brenda një kohe të arsyeshme, duhet të provojë se cedimi është kryer. Në rast se cesionari nuk vepron në përputhje me këtë kërkesë, debitori i llogarisë çlirohet nga detyrimi në rast se paguan ceduesin, edhe sikur të ketë marrë njoftim.

Debitori i llogarisë, që ka marrë lajmërim për cedimin e llogarisë, ka të drejtë të marrë nga cesionari një shënim, me anë të të cilit bëhet e ditur se debitori i llogarisë çlirohet nga çdo detyrim i mëtejshëm ndaj cesionarit, në qoftë se nuk ka mbetur pjesë e detyrimit e papaguar dhe cesionari nuk ka detyrim të japë kredi, të marrë përsipër një detyrim të ri, ose të paguajë në ndonjë mënyrë tjetër.

Çlirimi nga detyrimi, duhet të bëhet brenda një periudhe të arsyeshme, por jo më vonë se 3 ditë pune pasi ceduesi të ketë marrë kërkesën nga debitori i llogarisë. Rregulli i parashikuar në këtë paragraf nuk zbatohet për shitjen e llogarisë.

#### KREU IV REGJISTRI I BARRËVE SIGURUESE

##### Neni 25

##### **Regjistri i Barrëve Siguruese**

*(Ndryshuar paragrafi i dytë dhe shfuqizuar paragrafi i tretë, me ligjin nr.9524, datë 25.4.2006, ndryshuar me ligjin nr. 10 022, datë 24.11.2008)*

Regjistri i barrëve siguruese krijohet dhe ofron shërbimin e regjistrimit të barrëve siguruese, të pretendimeve dhe të të drejtave, që lindin nga ky ligj ose nga çdo ligj tjetër, i cili kërkon ose lejon regjistrimin në këtë regjistër.

Ministria përgjegjëse për ekonominë është përgjegjëse për veprimtarinë e regjistrimit të barrëve siguruese.

Në rastet kur ky shërbim i delegohet një personi juridik privat, në formën e koncesionit, sipas ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", ofruesi i shërbimit i propozon ministri përgjegjës për ekonominë emërimin e kryeregjistruesit të regjistrimit të barrëve siguruese dhe të një ose disa zëvendësve të tij.

Në të gjitha rastet, regjistri i barrëve siguruese është pronë publike.

##### Neni 26

##### **Rregullorja e barrëve siguruese**

*(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.9524, datë 25.4.2006)*

- Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr dhe miraton rregulloren e barrëve siguroese për:
- a) përcaktimin e detyrave të Kryeregjistruesit;
  - b) përcaktimin e vendndodhjes dhe të orarit të punës së Regjistrimit;
  - c) caktimin e pagesave për shërbimet që kryen Regjistri dhe mënyrën e pagimit të tyre; ç) përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe të mënyrës së regjistrimit të njoftimeve mbi bazën e të cilave regjistrohen barrët siguroese;
  - d) përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe mënyrës së përdorimit të çdo njoftimi tjetër të parashikuara në këtë ligj;
  - dh) mënyrën e përshkrimit të kolateralit në njoftimin e regjistrimit, duke përfshirë të ardhurat kolateral dhe përcaktimin e llojit të mallrave që do të përshkruhen me anë të numrit të serisë;
  - e) përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë një numër serie;
  - ë) përcaktimin e kohës, vendit dhe të gjitha çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me kërkimin në Regjistrim dhe me mënyrën e dhënies së informacionit të regjistruar, duke përfshirë formularin e përgjigjes për rezultatin e kërkimit;
  - f) përcaktimin e afatit gjatë të cilit regjistrimi është i vlefshëm;
  - g) përcaktimin e shumës që duhet t'i paguhet barrëmarrësit sipas nenit 7; dhe
  - gj) çdo gjë tjetër që nevojitet për funksionimin si duhet të Regjistrimit.

#### Neni 27

#### **Përgjegjësia e Këshillit të Ministrave**

*(Shtuar një paragraf me ligjin nr. 10 022, datë 24.11.2008)*

Këshilli i Ministrave bën përcaktimin e kufijve për shumat që mund të mbulohen nga Këshilli i Ministrave për humbjen e shkaktuar si rezultat i gabimeve ose mosfunksionimit në rregull të sistemit të Regjistrimit.

Në rastet kur ky shërbim ofrohet nga një subjekt juridik privat, ofruesi i shërbimit është përgjegjës për humbjen e shkaktuar, si rezultat i gabimeve ose mosfunksionimit të sistemit të regjistrimit. Kufijtë e përgjegjësisë dhe mënyra se si do të garantohet mbulimi i humbjeve përcaktohen në kontratën e lidhur ndërmjet palëve.

Shteti nuk ka detyrim të mbulojë efektet (humbjet), në rast të deklarimit të barrëve false.

#### Neni 28

#### **Regjistrimi në Regjistrim**

*(Shfuqizuar shkronja "j" dhe "k" me ligjin nr. 10185, datë 5.11.2009)*

a) Për të regjistruar, ndryshuar ose fshirë regjistrimin apo nënrenditur barrën siguroese, përdoren vetëm formularët e përcaktuar nga Rregullorja.

Regjistrimi, ndryshimi, fshirja e regjistrimit apo nënrenditja e barrës siguroese janë të vlefshme që nga koha kur informacioni që përmban formulari përkatës pranohet nga Regjistri dhe është i gjetshëm në sistemin e Regjistrimit.

b) Regjistrimit dhe ndryshimit të regjistrimeve u caktohen numra që tregojnë kohën e kryerjes së regjistrimit apo të ndryshimit të tyre.

c) Njoftimi mund të regjistrohet përpara ose pasi palët nënshkruajnë marrëveshjen siguroese, përpara ose pas lidhjes së barrës siguroese.

ç) Njoftimi i regjistrimit mund të përfshijë më shumë se një barrë siguroese dhe më

shumë se një marrëveshje siguroese.

d) Përveç rasteve kur është fshirë, regjistrimi mbetet i vlefshëm për afatin që shënohet në njoftimin e regjistrimit në përputhje me Rregulloren e barrëve siguroese.

dh) Regjistrimi është i pavlefshëm në qoftë se ai nuk mund të gjendet në Regjistër me anë të emrit të barrëdhënësit ose, në rastin e barrës siguroese mbi mallra me numër serie, me anën e numrit të serisë.

e) Kryeregjistruesi mund të refuzojë të regjistrojë një njoftim regjistrimi, ndryshimi, fshirjeje ose nënrenditjeje të barrës siguroese kur, sipas mendimit të Kryeregjistruesit, njoftimi nuk është kryer në përputhje me kërkesat e këtij ligji apo të Rregullores së barrëve siguroese. Kryeregjistruesi duhet t'i japë me shkrim palës që bën regjistrimin arsyet për refuzimin e regjistrimit të njoftimit.

ë) Kur Kryeregjistruesi çmon se ka rrethana që nuk lejojnë kryerjen me efikasitet të një ose disa shërbimeve të Regjistrit, ai mund të refuzojë të regjistrojë një njoftim regjistrimi, një kërkesë për të marrë të dhëna ose mund të ndërpresë një ose disa veprime të Regjistrit. Kur Kryeregjistruesi çmon se situata vazhdon të jetë e papërshtatshme, atëherë ai mund të vazhdojë të refuzojë dhe ndërpresë veprimet e mësipërme, për aq kohë sa zgjat situata e papërshtatshme.

f) Barrëmarrësi mund ta zgjatë afatin e regjistrimit të një njoftimi duke ia bërë këtë të ditur Regjistrit me anë të njoftimit për zgjatjen. Njoftimi për zgjatjen duhet kryer përpara se të ketë mbaruar afati i regjistrimit të mëparshëm.

g) Barrëmarrësi mund të fshijë pjesërisht apo plotësisht regjistrimin duke i transmetuar Regjistrit njoftimin e fshirjes.

gj) Barrëmarrësi që ka regjistruar barrën siguroese dhe, më pas, ka transferuar pronësinë e një pjese apo të të gjithë kolateralit, mund të ndryshojë regjistrimin që lidhet me kolateralin e transferuar. Për këtë ai njofton Regjistrin me anë të një njoftimi ndryshimi, që përmban emrin e personit në favor të të cilit është bërë transferimi dhe përshkrimin e kolateralit pronësia e të cilit është transferuar. Nga çasti i regjistrimit të ndryshimit, sipas këtij ligji, personi në favor të të cilit është bërë transferimi konsiderohet se ka barrë siguroese të regjistruar mbi kolateralin e transferuar.

h) Barrëmarrësi që ka regjistruar barrën siguroese dhe ka pranuar të nënrenditë barrën e tij ndaj barrës së një personi tjetër, mund t'ia bëjë këtë të ditur Regjistrit me anë të një njoftimi për nënrenditjen e kësaj barre. Regjistrimi që ka lidhje me barrën siguroese ndryshohet për të pasqyruar nënrenditjen e kësaj barre.

i) Kryeregjistruesi duhet të fshijë një regjistrim nga Regjistri kur është një nga rastet e mëposhtme:

- regjistrimi bëhet i pavlefshëm; ose
- ai merr një njoftim të vlefshëm për fshirjen e regjistrimit; ose
- gjykata urdhëron fshirjen e regjistrimit.

j) Shfuqizuar.

k) Shfuqizuar.

l) Kur një regjistrim ka lidhje me një barrë siguroese mbi mallra konsumi, barrëmarrësi duhet të fshijë regjistrimin jo më vonë se 15 ditë pasi të gjitha detyrimet e siguruara nga barra siguroese janë shlyer. Barrëmarrësi i cili nuk vepron kështu duhet t'i paguajë barrëdhënësit, emri i të cilit gjendet në regjistrim, shumën prej 13,000 lek dhe kompensimin për humbjet e shkaktuara.

Barrëdhënësi ose çdo person tjetër pasuria e të cilit përfshihet në përshkrimin e kolateralit mund t'i dërgojë kërkesë me shkrim barrëmarrësit, që ky t'i kërkojë Regjistrin ndryshimin apo

fshirjen e plotë të regjistrimit kur:

- detyrimet në lidhje me barrën e regjistruar janë shlyer; ose
- përshkrimi i kolateralit që përmban Regjistri përfshin një zë ose lloj pasurie që nuk përbën kolateral sipas marrëveshjes siguroese; ose
- nuk ka marrëveshje siguroese ndërmjet barrëdhënësit dhe barrëmarrësit.

Barrëmarrësi duhet të veprojë në përputhje me këtë kërkesë jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së kërkesës me shkrim.

ll) Nëse fshirja ose ndryshimi i regjistrimit nuk bëhet brenda afatit të përmendur në pikën l, personi që i ka bërë kërkesën barrëmarrësit mund t'i kërkojë gjykatës të nxjerrë një urdhër sipas të cilit barrëmarrësi duhet të fshijë ose ndryshojë regjistrimin.

Gjykata duhet të nxjerrë urdhërin brenda 10 ditëve nga data kur është bërë kërkesa.

Kur urdhëri i gjykatës i dorëzohet Kryeregjistruesit, Kryeregjistruesi duhet të fshijë ose ndryshojë regjistrimin siç kërkohet nga urdhëri.

Barrëmarrësi, kundrejt të cilit është nxjerrë një urdhër gjykate, duhet t'i paguajë personit që ka bërë kërkesën të cilës i referohemi në pikën l, shumën prej 13,000 lek dhe kompensimin për humbjet e shkaktuara nga ky person si rezultat i mospërputhjes me kërkesën në pikën l.

m) Me përjashtim të rastit kur ka marrëveshje të kundërt të palëve përpara bërjes së kërkesës sipas pikës l, barrëmarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblim për kryerjen prej tij të veprimeve në përputhje me pikën l.

n) Kur barra siguroese është kompletuar me regjistrim dhe barrëdhënësi ka tjetërsuar kolateralin ose ka ndryshuar emrin, barra siguroese humbet kompletimin 20 ditë pasi barrëmarrësi të ketë marrë dijeni për tjetërsimin e kolateralit ose ndryshimin e emrit, me përjashtim të rastit kur barrëmarrësi regjistron një njoftim ndryshimi që përmban emrin e pronarit të ri të pasurisë ose emrin e ri të barrëdhënësit përpara mbarimit të afatit prej 20 ditësh.

Kur barrëmarrësi jep pëlqimin për shitjen e kolateralit përpara se të jetë kryer shitja, afati prej 20 ditësh fillon kur blerësi fiton pronësinë mbi kolateralin.

nj) Kur është e përshtatshme, kushtet e këtij neni zbatohen edhe për regjistrimin e pretendimeve të shtetit që lindin nga ligje të tjera.

Neni 28/1

### **Certifikata për të dhënat e regjistrimit**

*(Shtuar me ligjin nr.10 185, datë 5.11.2009)*

1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion, të shkruar ose në formë elektronike, për të dhënat e regjistrimit, sipas kritereve e procedurave të përcaktuara në rregulloren e barrëve siguroese.

2. Certifikata për të dhënat e regjistrimit është akti shkresor, i lëshuar nga kryeregjistruesi ose akti në formë elektronike, që provon të gjitha faktet e marra nga regjistri, përfshirë datën, ndryshimin, shuarjen ose nënrenditjen dhe radhën e regjistrimit.

3. Ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për ekonominë, bazuar në parimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të sigurisë juridike, përcaktojnë, me udhëzim, rastet, formën e certifikatës, afatet dhe procedurat kur noterët kërkojnë informacion të shkruar për të dhënat e regjistrimit.

## **KREU V**

### **MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE, MJETET LIGJORE DHE EKZEKUTIMI**



## Neni 29

### **Të drejtat ligjore të palëve në rast mospërbushjeje të detyrimeve**

Kreu V zbatohet për të gjitha transaksionet e përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji, përveç atyre të përcaktuara në pikën b, c ose ç të tij.

Kur barrëdhënësi nuk përmbush detyrimet e marrëveshjes siguroese, barrëmarrësit i linden të drejtat ligjore që parashikon ky ligj dhe çdo ligj tjetër si dhe ato të parashikuara në marrëveshjen siguroese, me kusht që ato të mos vijnë në kundërshtim me ligjin.

Kur barrëmarrësi ka marrë posedimin e kolateralit, ai dhe barrëdhënësi gëzojnë përveç të tjerash edhe të drejtat e parashikuara nga neni 6.

Barrëdhënësi gëzon të drejtat dhe mund të përdorë mjetet ligjore që parashikon ky ligj dhe çdo ligj tjetër, si edhe të gjitha të drejtat ligjore të parashikuara nga marrëveshja siguroese, me kusht që ato të mos vijnë në kundërshtim me ligjin.

Kur barrëdhënësit i kufizohen të drejtat ligjore ose ai heq dorë prej tyre, me ose pa marrëveshje, përpara mospërbushjes, heqja dorë ose kufizimet nuk zbatohen nëse ai vendos t'i ushtrojë këto të drejta.

Të gjitha të drejtat, detyrat dhe detyrimet që linden nga marrëveshja siguroese ose që parashikohen në këtë ligj duhet të ushtrohen dhe përmbushen në mirëbesim dhe në përputhje me normat e arsyeshme tregtare.

## Neni 30

### **Arkëtimi i llogarive dhe instrumenteve nga barrëmarrësi**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

Kur kolaterali është llogari, instrument ose titull, barrëmarrësi ka të drejtë të njoftojë debitorin e llogarisë ose personin që ka detyrime nga instrumenti ose titulli që t'i paguajë barrëmarrësit shumën e llogarisë, të instrumentit ose titullit dhe pasi të ketë zbritur shpenzimet e arsyeshme të bëra për arkëtimin, t'i përdorë paratë e arkëtuara për përmbushjen e detyrimit të siguruar nëpërmjet barrës siguroese.

## Neni 31

### **Ekzekutimi**

Marrëveshja siguroese është titull ekzekutiv dhe, në rast mospërbushjeje, ekzekutohet nga përmbaruesi gjyqësor me urdhër të gjykatës kompetente.

Urdhëri i ekzekutimit urdhëron përmbaruesin gjyqësor të sekuestrojë kolateralin e përshkruar në marrëveshjen siguroese dhe t'ia japë atë barrëmarrësit ose personit të autorizuar prej tij. Zyra e përmbarimit nuk ka detyrim të njoftojë paraprakisht personin që posedon kolateralin për sekuestrimin.

Palët detyrohen të paguajnë shpenzimet dhe taksat në lidhje me zbatimin e këtij urdhëri, të cilat parashikohen në Rregulloren e barrëve siguroese.

Zyra e përmbarimit mund të refuzojë të fillojë ose të vazhdojë procedurat e sekuestrimit të kolateralit deri sa të paguhet taksat dhe shpenzimet përkatëse.

## Neni 32

### **Të drejtat e palëve për mbrojtje**

Barrëdhënësi, barrëmarrësi ose çdo person tjetër të cilit i preken të drejtat nga ekzekutimi, mund t'i drejtohet gjykatës duke i kërkuar:

a) të marrë një vendim që përcakton nëse barrëdhënësi nuk ka përmbushur detyrimet sipas marrëveshjes siguroese;

b) të lëshojë urdhër për të mbrojtur të drejtat e çdo personi mbi kolateralin;

c) të lëshojë urdhër për pezullimin e sekuestrimit ose shitjes së kolateralit;

ç) të lëshojë urdhër që përmban procedura të veçanta për barrëmarrësin ose përmbaruesin gjyqësor, për mënyrën e ekzekutimit të marrëveshjes siguroese dhe, kur është e përshtatshme, një urdhër që përmbaruesi gjyqësor, i cili ka sekuestruar kolateralin, t'ia kthejë atë debitorit;

d) të lëshojë urdhër ku i kërkohet një personi që të veprojë në përputhje me një ose më shumë kërkesa procedurale për ekzekutimin e marrëveshjes siguroese sipas këtij ligji;

dh) të lëshojë urdhër për sekuestrimin dhe shitjen e kolateralit me anë procedurash të tjera kur ekzekutimi, sipas këtij ligji, i procedurave të përcaktuara në këtë nen është i pamundur ose jo i arsyeshëm për t'u ndjekur;

e) të lëshojë urdhër që detyron një person të paguajë shpenzimet për ekzekutimin që parashikohet në Rregulloren e barrëve siguroese.

Gjykata lëshon urdhërin brënda 10 ditëve nga regjistrimi i kërkesës.

## Neni 33

### **Dorëzimi i kolateralit barrëmarrësit pas sekuestrimit**

Pas sekuestrimit, përmbaruesi gjyqësor duhet t'i dorëzojë barrëmarrësit, apo një personi të përcaktuar me shkrim prej tij, kolateralin e sekuestruar.

## Neni 34

### **Sekuestrimi dhe shitja e kolateralit në vendndodhjen e barrëdhënësit**

Kur kolaterali është i tillë që nuk mund të lëvizet me lehtësi nga vendndodhja e barrëdhënësit apo është i atij lloji për të cilin nuk mund të gjenden me lehtësi vende të përshtatshme për depozitim, kolaterali mund të sekuestrohet edhe pa u lëvizur nga vendndodhja e barrëdhënësit, dhe barrëmarrësi mund ta shesë atë në vendndodhjen e barrëdhënësit.

Barrëmarrësi nuk duhet ta shesë kolateralin në vendndodhjen e barrëdhënësit nëse kjo sjell rrethana të papërshtatshme ose kërkon shpenzime që nuk janë të nevojshme për tjetërsimin.

Kolaterali mund të shitet nga barrëmarrësi në gjëndjen ekzistuese ose pasi të jetë riparuar. Të ardhurat nga shitja duhet të përdoren për të mbuluar taksat për zyrën e përmbarimit, siç parashikohet në Rregulloren e barrëve siguroese, shpenzimet e arsyeshme për depozitimin, riparimin me qëllim shitjeje dhe shpenzime të tjera të arsyeshme të bëra nga barrëmarrësi, dhe vetëm pjesa që mbetet përdoret për të përmbushur detyrimet sipas marrëveshjes siguroese.

Shumat që teprojnë pas shlyerjeve sipas paragrafit të mësipërm do t'i paguhen çdo barrëmarrësi tjetër që ka barrë siguroese të nënrenditur dhe që ka njoftuar barrëmarrësin përpara se të bëhet shpërndarja e shumave të mësipërme dhe, në qoftë se nuk është bërë njoftim, ato i paguhen barrëdhënësit.

Neni 35  
**Njoftimi për shitjen**

Të paktën 10 ditë përpara shitjes së kolateralit, barrëmarrësi duhet t'i japë një njoftim për shitjen barrëdhënësit dhe çdo personi tjetër që ka barrë siguruese të nënrenditur mbi kolateralin, por vetëm nëse barra siguruese është regjistruar në Regjistër përpara se barrëdhënësit t'i jetë dhënë njoftimi për tjetërsimin.

Njoftimi për shitjen duhet të përmbajë:

- a) përshkrimin e kolateralit;
- b) shumën e papaguar të detyrimit sipas marrëveshjes;
- c) shumën e shpenzimeve të bëra dhe kur kjo shumë nuk është përcaktuar ende, një vlerësim të arsyeshëm të saj;
- ç) një deklaratë ku thuhet se pas pagimit të shumës së kërkuar, personi që ka të drejtë të marrë njoftim, mund ta rimarrë kolateralin;
- d) një deklaratë ku theksohet se, po të mos rimerret kolaterali, ai do të shitet dhe barrëdhënësi do të përgjigjet për çdo detyrim që mbetet pa paguar prej shumës që është përftuar nga shitja; dhe
- dh) ditën, orën dhe vendin e shitjeve në ankand, ose vendin ku tenderat e mbyllur mund të dorëzohen dhe datën në të cilën nuk pranohen tenderat e mbyllur, ose datën pas së cilës do të bëhet shitja private e kolateralit.

Kolaterali mund të shitet pjesërisht ose tërësisht, privatisht ose publikisht, në ankand publik ose tendera të mbyllur, i tëri ose në njësi, por gjithmonë brenda normave të arsyeshme tregtare.

Barrëmarrësi mund ta blejë kolateralin ose një pjesë të tij vetëm në shitjet publike dhe vetëm kundrejt një çmimi të arsyeshëm, të afërt me vlerën tregtare të kolateralit.

Nuk kërkohet njoftim për shitjen kur:

- a) barrëmarrësi çmon se kolateralit do t'i bjerë vlera në mënyrë të konsiderueshme nëse ai nuk shitet menjëherë pas mospërmbushjes; ose
- b) shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të depozitimit të kolateralit janë të larta në krahasim me vlerën e tij; ose
- c) pas mospërmbushjes, çdo person që ka të drejtë të njoftohet për shitjen, heq dorë me shkrim nga kjo e drejtë; ose
- ç) gjykata çmon se njoftimi nuk është i nevojshëm.

Neni 36  
**Raportimi pas tjetërsimit**

Barrëmarrësi duhet t'i japë barrëdhënësit dhe barrëmarrësve të nënrenditur, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së një kërkese me shkrim prej tyre, një deklaratë me shkrim për:

- a) shumën e përftuar nga tjetërsimi i kolateralit;
- b) shumën e përdorur për shpenzimet;
- c) shpërndarjen e shumës së marrë nga tjetërsimi; dhe
- ç) shumën e çdo mbivlere.

#### Neni 37

### **Pagimi i detyrimit dhe mbajtja e kolateralit**

Pas mospërbushjes, barrëdhënësi mund të pranojë propozimin e barrëmarrësit që ky i fundit ta marrë kolateralin me anë të të cilit detyrimi konsiderohet i shlyer. Barrëmarrësi duhet t'i japë njoftim për këtë propozim:

a) barrëdhënësit; dhe

b) personave që kanë barrë siguroese të nënrenditura në kolateral ndaj asaj të barrëmarrësit dhe që kanë regjistruar njoftim në Regjistër sipas këtij ligji përpara ditës në të cilën ka marrë njoftim barrëdhënësi.

Nëse personi i cili ka të drejtë të marrë njoftim kundërshton propozimin e barrëmarrësit brenda 15 ditëve pas marrjes së njoftimit për propozimin, barrëmarrësi duhet të vazhdojë procedurat për shitjen e kolateralit.

Nëse kundërshtimi nuk njoftohet brenda 15 ditëve, barrëmarrësi konsiderohet se ka marrë kolateralin në përmbushje të detyrimit të siguar siç është parashikuar në propozim, dhe ka të drejtë ta mbajë e ta shesë kolateralin të parënduar nga pronësia mbi të e barrëdhënësit apo ndonjë barrë tjetër siguroese e nënrenditur për të cilën është dhënë njoftim.

#### Neni 38

### **E drejta e barrëdhënësit për të rimarrë kolateralin**

Përpara shitjes ose mbajtjes së kolateralit nga barrëmarrësi sipas nenit 37 ose lidhjes së një kontrate shitjeje të kolateralit, barrëdhënësi apo barrëmarrës të nënrenditur, mund të rimarrin kolateralin kundrejt shlyerjes së detyrimit të papërbushur. Në këtë rast ata detyrohen të paguajnë edhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për sekuestrimin, mbajtjen, riparimin dhe përgatitjen e kolateralit për shitje.

Barrëdhënësi mund të heqë dorë me shkrim nga rimarrja e kolateralit vetëm pas mospërbushjes.

#### Neni 39

### **Mbrojtja e blerësit të kolateralit**

Kur barrëmarrësi ia shet kolateralin një blerësi në mirëbesim, blerësi që e merr kolateralin në posedim e fiton atë të lirë nga pretendimet e debitorit, pretendimet e nënrenditura ndaj pretendimeve të debitorit dhe të barrëmarrësve të nënrenditur, edhe në rast se nuk janë përmbushur kërkesat e këtij ligji.

#### Neni 40

### **Shpërblimi i dëmit**

Kur barrëmarrësi nuk respekton kërkesat e këtij ligji dhe shkakton dëm, ai detyrohet të shpërblejë dëmin që mund të shkaktohet sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

## KREU VI

### NORMA TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE PRIVATE

Neni 41

**Ligji i zbatueshëm**

*(Ndryshuar shkronjat "a" dhe "b" me ligjin nr. 101/2016, datë 20.10.2016)*

a) Vlefshmëria, kompletimi dhe preferimi i barrës siguroese rregullohen nga ligji i vendit ku ndodhet barrëdhënësi në çastin që jepet barra, në rast se kolaterali i kësaj barre është:

- i) llogari, instrument ose para dhe është kompletuar me regjistrim;
- ii) automjet që nuk është mall konsumi, aeroplan ose vagon treni që nuk është inventar;

Vendndodhja e barrëdhënësit, është vendi kryesor ku ai ushtron veprimtari tregtare ose vendbanimi i tij, në qoftë se nuk zhvillon veprimtari tregtare. Vendndodhja e personit juridik është vendi i selisë së tij.

b) Vlefshmëria, kompletimi dhe preferimi i barrës siguroese rregullohen nga ligji i vendit në të cilin ndodhet kolaterali në çastin e dhënies së barrës, në rast se kolaterali i kësaj barre është:

- i) një automjet që është mall konsumi;
- ii) një mall që nuk përmendet në shkronjën "a" të këtij neni;
- iii) një instrument ose para, kur këto janë në posedim të barrëmarrësit.

c. Kur kolaterali, që është mallra, vjen në Shqipëri nga një vend tjetër me barrë siguroese mbi të dhe, brenda 60 ditësh pas datës së ardhjes së kolateralit barra siguroese kompletohet në Shqipëri, barra siguroese mbetet në vazhdimësi e kompletuar në Shqipëri. Kur kolaterali blihet ose merret me qira përpara se barra siguroese të jetë kompletuar në Shqipëri, blerësi ose qiramarrësi i kolateralit e merr atë të parënduar prej saj.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 42

Ky ligj nuk zbatohet për transaksione të kryera para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Megjithatë, pretendimet për preferimin ndërmjet të drejtave që ekzistojnë para hyrjes në fuqi të ligjit me të drejta ose barrë siguroese të krijuara pas hyrjes së tij në fuqi, u nënshtrohen rregullave të përcaktuara në nenet 11, 12, 13, 14, 15 dhe 19, si dhe në kreun IV.

E drejta në transaksionet që përmenden në paragrafin e mësipërm konsiderohet e kompletuar përpara të drejtave që krijohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me kusht që kreditori të kryejë një nga veprimet e përcaktuara nga shkronjat "a", "b" ose "c" të nenit 8, brenda 90 ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 43

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi më datën 1 janar 2000.

**Shpallur me dekretin nr.2468, datë 28.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**